



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

MARS 2023

# EKONOMIA DHE BUXHETI

## Raport Mujor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Mars 2023

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2023  
Drejtoria e Analizave Makroekonomike dhe Statistikave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

[www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al)

**E-mail:** [Dajana.Metolli@financa.gov.al](mailto:Dajana.Metolli@financa.gov.al)

# Përmbajtja

**VEÇORITË KRYESORE** \_\_\_\_\_ **2**

**ZHVILLIMET EKONOMIKE** \_\_\_\_\_ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit \_\_\_\_\_ 3
2. Kursi mesatar i Këmbimit \_\_\_\_\_ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave \_\_\_\_\_ 5
4. Bilanci i Pagesave \_\_\_\_\_ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar \_\_\_\_\_ 7
6. Kredia për Ekonominë \_\_\_\_\_ 8
7. Oferta e Parasë \_\_\_\_\_ 9
8. Depozitat sipas burimeve \_\_\_\_\_ 10

**SEKTORI FISKAL** \_\_\_\_\_ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar \_\_\_\_\_ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve \_\_\_\_\_ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal \_\_\_\_\_ 13

**ANEKSI STATISTIKOR** \_\_\_\_\_ **13**


# Veçoritë Kryesore

- Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Mars 2023, arriti në 114.67;
- Norma vjetore e inflacionit për muajin Mars 2023 ishte 5.31 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Mars 2023 ishte 106.91 lekë për dollarë dhe 114.35 lekë për euro;
- Normat mesatare të interesit të depozitave në lekë sipas individëve dhe korporatave jo-financiare gjatë muajit Mars 2023 shënuan kuotën 1.46 dhe 1.78 përqind;
- Normat mesatare të interesit të huave në lekë sipas Individëve dhe korporatave jo-financiare gjatë muajit Mars 2023 shënuan përkatësisht vlerat 7.61 dhe 7.62 përqind;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,651,678 milionë lekë në muajin Mars 2023, duke shënuar një rritje prej rreth 3.7 përqind krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e katërt të 2022 rezultoi me rënie të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 11.64 milionë euro;
- Situata Buxhetore për periudhën Mars 2023 rezultoi me një sufiçit të përgjithshëm prej rreth 30.9 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një sufiçit prej 11.3 miliardë lekë;
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Mars 2023, arritën në rreth 156.1 miliardë lekë ose afërsisht 1.3% më shumë se për këtë periudhë;
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 125.2 miliardë lekë ose rreth 12.3% më pak se shpenzimet të planifikuara për këtë periudhë;

# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Mars 2023 ishte 5.3%, një vit më parë ky ndryshim ishte 5.7%. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Mars 2023, krahasuar me Shkurt 2023 është 0.7%. Një muaj më parë, Shkurt 2023, IÇK shënoi një rritje mujore prej 1.1%. Referuar një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Mars 2022 shënoi rritje mujore prej 2.4 %, në krahasim me muajin paraardhës.



Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

- “Ushqime dhe pije joalkolike” me rritje vjetore të çmimit prej +11.0%, duke kontribuar me +3.94 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +5.3%.
- “Qera, ujë lëndë djegëse dhe energji” me rritje vjetore të çmimit prej +2.6%, duke kontribuar me +0.48 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +5.3%.
- “Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje”, me rritje vjetore +6.6%, duke kontribuar me

+0.47 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +5.3%.

- “Hotele, kafene dhe restorante” me rritje vjetore të çmimit prej +4.6%, duke kontribuar me +0.21 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +5.3%.
- “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me rritje vjetore të çmimit prej +3.2%, duke kontribuar me +0.18 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +5.3%.
- “Pije alkolike dhe duhan” me rritje vjetore të çmimit prej +2.8%, duke kontribuar me +0.14 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +5.3 %.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
<b>2022</b>	3.7	3.9	<b>5.7</b>	6.2	6.7	7.4	7.5	8	8.1	8.3	7.9	7.4
<b>2023</b>	7.2	7.1	<b>5.3</b>									

Burimi: INSTAT

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Mars 2023, arriti në 114.35 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me 1.18 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Mars, një euro u këmbye me 113.21 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Mars 2023 arriti në 106.91 lekë/dollarë duke shënuar rënie në vlerë me 0.99 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit Mars, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 103.96 lekë/dollarë.




Në krahasim me muajin Mars të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 7.00 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 4.19 përqind. Në pëgjithësi, forcimi i lekut kundrejt monedhave të huaja mund të jetë dhe natyrë shtrënguese e politikës monetare dhe fiskale në vënd. Gjithashtu, faktor tjetër në forcimin e lekut mund të ketë qënë edhe përmirsimi i bilancit tregëtar në fillim të këtij viti. Forcimi i monedhës vendase ndaj euros këtë vit ka ndihmuar në zbutjen e pjesshme të presioneve inflacioniste nga jashtë.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një nivel mesatar rreth 0.93 dollarë/euro për muajin Mars 2023.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë kësaj periudhe përmendim: qendrueshmëria e kursit të këmbimit për shkak të ndërhyrjes së shpejtë të BSH-së, stabiliteti i situatës makroekonomike në vënd, efikasiteti i politikës fiskale, efikasiteti në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga BSH-ja, etj.


### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Mars 2023, normat mesatare të interesit të depozitave me afat në lekë sipas Individëve dhe Korporatat jo-financiare shënuan përkatësisht vlerat prej 1.46 dhe 1.78 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave sipas individëve dhe Korporatat jo-financiare kanë shënuar rënie përkatësisht 0.05 dhe 0.52 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me një vit më parë kanë shënuar rritje me 0.87 pikë përqindje për Individët dhe 1.43 pikë përqindje për Korporatat jo-financiare.



Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore për muajin Mars 2023 kanë shënuar kuotën 3.94 përqind, nga 1.87 përqind që shënonte për të njëjtën periudhë një vit më parë. Bonoja 12-mujore pati rritje vjetore përkatësisht me 2.07 pikë përqindje dhe rënie mujore me 0.52 pikë përqindje.

Gjatë muajit Mars 2023 normat mesatare të interesit të huave sipas Individëve dhe korporatave jo-financiare shënuan përkatësisht vlerat 7.61 dhe 7.62 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të huave sipas individëve ranë me 0.28 pikë përqindje ndërsa normat e interesit sipas korporatave jo-financiare u rritën me 0.06 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me një vit më parë kanë shënuar rritje me 1.33 pikë përqindje për Individët dhe 2.94 pikë përqindje për Korporatat jo-financiare.





## 4. Bilanci i Pagesave

Përgjatë vitit 2022, Bilanci i Pagesave rezultoi negativ, me rënie të mjeteve të rezervës valutore, duke shënuar vlerën -70 milion euro, nga 936 milion euro që ishte një vit më parë (2021). Gjithashtu, vetëm për T4-2022, BP shënoi vlerën -11.6 milion euro, krahasuar me T4-2021 që shënoi vlerën 726.6 milion euro.

Përgjatë vitit 2022, deficioni i llogarisë korrente pati një ngushtim në vlerën -1,080 miliardë euro krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë që ishte -1,166 miliardë euro. Po ashtu, vetëm për T4-2022, llogaria korrente e ngushtoi deficionin në -477 milion euro, krahasuar me T4-2021 që ishte -541 milion euro.

Përgjatë vitit 2022, llogaria financiare dhe kapitale u ngushtua në vlerën +864 milionë euro krahasuar me +1,924 miliardë euro në vitin 2021. Gjithashtu, vetëm për T4-2022, llogaria financiare dhe kapitale u ngushtua në +323 milionë euro, krahasuar me +1,190 miliardë euro në T4-2021. Përgjatë vitit 2022, investimet e huaja direkte shënuan vlerën +1,372 miliardë euro ose +33.0%, krahasuar me +1,032 miliardë euro në vitin 2021. Gjithashtu, vetëm për T4-2022, IHD u zgjeruan në vlerën +388 mln euro ose +28.5%, krahasuar me +302 mln euro në T4-2021.


Përgjatë vitit 2022, të hyrat nga shërbimet të lidhura përgjithësisht me turizmin u zgjeruan në vlerën +2,840 miliardë euro, +48.5% (ose rreth 1.5 herë më shumë), krahasuar me +1,912 miliardë euro në vitin 2021.



Përgjatë vitit 2022, Remitancat shënuan rritje në vlerën +834 milionë euro, krahasuar me +761 milion euro në vitin 2021, ose +9.6%. Ndërsa vetëm për T4-2022, remitancat janë në vlerën +242 mln euro, ose +8.9%, krahasuar me +222 mln euro në T4-2021.


## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Mars 2023, sistemi bankar ka shënuar rënie të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 26,636 milionë lekë krahasuar me muajin Mars të vitit 2022. Kjo rënie ka ardhur kryesisht si pasojë e rënies së mjeteve valutore neto të Bankës Qëndrore me 26,826 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rënie me 12,670 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rënia mujore prej 11,439 milionë lekë e Bankës paradepozituese.




Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,651,678 milionë lekë në muajin Mars 2023, duke shënuar një rritje prej rreth 58,475 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 3.7 përqind.

Në muajin Shkurt 2023, sistemi bankar rezultoi me rënie mujore prej 13,611 milionë lekë.




## 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Mars 2023 arriti në rreth 711.061 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 27.736 milionë lekë, ose rritje me rreth 4.06 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (51.6%) dhe monedhave të huaja (48.4%).




Gjatë muajit Mars 2023, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 57.0 përqind ose 405.170 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 37.80 përqind ose rreth 268.557 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 2.9 dhe 2.3 përqind apo 20.753 dhe 16.403 milionë lekë.




Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin Mars 2023, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 67.7 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 26.4 përqind. “Korporata të tjera financiar” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.1 dhe 3.7 përqind secili.

## 7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 382.754 milionë lekë në fund të muajit Mars 2023. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Mars 2023 ka shënuar një rritje mujore prej 0.05 përqind dhe rritje vjetore prej 0.2 përqind, duke arritur nivelin 23.2 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rritje mujore prej 0.08 përqind, dhe rritje vjetore prej 0.34 përqind, duke shënuar nivelin 30.2 përqind.




Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Mars 2023, kanë shënuar rritje vjetore prej 33.623 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 73.9 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit Mars 2023 shënuan rritje prej 8.017 milionë lekë në krahasim me muajin Mars 2022. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 78.7 përqind të depozitave në lekë.




## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Mars 2023, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 78.7 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 15.5 përqind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 3.5 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 73.9 përqind dhe rreth 22.9 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 76.0 përqind e totalit.



Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 964.080 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (249.756 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (26.364 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (26.769 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.956 milionë lekë) në totalin e depozitave. Gjatë muajit Mars 2023, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1,268,925 milionë lekë.




Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rënie prej rreth 11.261 milionë lekë. Ndërsa, krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 41.640 milionë lekë.

# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Mars 2023 janë mbledhur rreth 156.107 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 125.232 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 112.498 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 48.598 miliardë lekë në shpenzime për fonde speciale.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 104.674 miliardë lekë (1.7% më shumë se plani i periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 5.070 miliardë lekë (37.7% më pak se plani i periudhës). Të ardhurat nga fondet speciale janë rreth 33.783 miliardë lekë (ose rreth 7.6% më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 5.271 miliardë lekë (ose rreth 5.9% më shumë se plani i periudhës).



Nga totali i shpenzimeve korrente prej 112.498 miliardë lekë, 21.963 miliardë lekë (19.5% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 12.051 miliardë lekë (10.7% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime interesi, 10.294 miliardë lekë (9.1% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 378 milion lekë (0.3% e totalit të shpenzimeve korrente) për subvencione, 48.598 miliardë lekë (43.2%) për shpenzime për fonde speciale, 12.528 miliardë lekë (11.1% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 6.685 miliardë lekë (5.9% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime të tjera.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar-Mars 2023 ishin rreth 156.1 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 143.5 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 5.3 miliardë lekë.

Tab - 2

Të ardhurat gjatë muajit Mars 2023 (mln Lekë)

Emërtimi	Mars '23	Mars'22	Mars'23/Mars'22 Rritja në (%)
Tatimi mbi Vleren e Shtuar	45,902	45,639	0.6
Tatimi mbi Fitimin	21,608	14,277	51.3
Akcizat	12,056	11,367	6.1
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	13,236	10,569	25.2
Taksa Nacionale dhe të tjera	9,895	12,153	-18.6
Taksa Doganore	1,977	1,728	14.4

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Statistikat Fiskale: Mars- 2023

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 30.88 miliardë lekë për periudhën Mars 2023, u mbështet kryesisht nga huamarrja e brendshme si mjeti kryesor i financimit të brendshëm dhe huasë afatgjatë të huaj.

Për periudhën Mars 2023, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 156.10 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 125.23 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për periudhën Mars 2023, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 143.53 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 112.49 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 48.59 miliardë lekë.

## Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly)					Vjetor (Annual)					Month
	2019	2020	2021	2022	2023	2019	2020	2021	2022	2023	2019	2020	2021	2022	2023	
Janar	1.6	1.9	1.3	1.3	1.1	1.6	1.9	1.3	1.3	1.1	1.9	1.5	0.4	3.7	7.2	January
Shkurt	0.6	0.4	1.1	1.3	1.1	1.1	1.1	1.2	1.3	1.1	1.7	1.2	1.1	3.9	7.1	February
<b>Mars</b>	-0.3	0.6	0.7	2.4	<b>0.7</b>	0.6	0.9	1.0	1.7	<b>1.0</b>	1.1	2.1	1.2	5.7	<b>5.3</b>	March
Prill	-0.2	-0.4	0.2	0.7		0.4	0.6	0.8	1.4		1.4	1.9	1.9	6.2		April
Maj	-1.0	-0.8	-0.9	-0.5		0.1	0.3	0.5	1.0		1.5	2.1	1.8	6.7		May
Qershor	-0.3	-0.6	-0.8	-0.1		0.1	0.2	0.3	0.9		1.3	1.8	1.6	7.4		June
Korrik	-0.1	-0.5	0.1	0.2		0.0	0.1	0.2	0.8		1.5	1.4	2.2	7.5		July
Gusht	0.3	0.2	0.4	0.8		0.1	0.1	0.3	0.8		1.5	1.3	2.4	8.0		August
Shtator	0.1	0.4	0.5	0.6		0.1	0.1	0.3	0.7		1.3	1.5	2.5	8.1		September
Tetor	-0.2	0.2	0.1	0.4		-0.1	0.1	0.3	0.7		1.3	2.0	2.4	8.3		October
Nëntor	-0.2	-0.5	0.2	-0.3		0.0	0.1	0.3	0.6		1.4	1.6	3.1	7.9		November
Dhjetor	-0.2	0.3	0.8	0.4		-0.1	0.1	0.3	0.6		1.4	1.1	3.7	7.4		December

Burimi : INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2

## Kursi i këmbimit

Exchange rate

Monedha					2023	2023	2023	Currency
	2019	2020	2021	2022	Janar January	Shkurt February	Mars March	
<b>Mesatarja e periudhës:</b>								<b>Average of period</b>
USD	109.85	108.65	103.68	113.04	107.90	107.98	106.91	USD
EURO	123.01	123.77	122.37	118.98	116.39	115.72	114.35	EURO
<b>Fundi i periudhës</b>								<b>In the end of period</b>
USD	108.64	100.84	106.54	113.03	107.72	108.43	103.96	USD
EURO	121.77	123.70	120.76	118.71	116.55	115.04	113.21	EURO

**Burimi** : Banka e Shqipërisë**Source** : Bank of Albania

**Tab - 3** Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)  
Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2023 Janar January	2023 Shkurt February	2023 Mars March	In percent
<b>Norma e interesit të depozitave për individë</b>				<b>Interest rates on households deposits</b>
Deri në 1 vit	1.06	1.08	1.02	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	1.72	1.93	1.53	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	2.89	2.83	2.84	Over 2 years
<b>Norma e interesit të depozitave për korporatat jo-financiare</b>				<b>Interest rates on nonfinancial corporations deposits</b>
Deri në 1 vit	2.15	1.34	1.76	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	4.97	3.61	2.47	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	3.32	3.19	2.35	Over 2 years
<b>Normat e interesit të kredive per individet</b>				<b>Interest rates on household loans</b>
Kredi për banesa	4.41	4.31	4.42	Lending for house purchase
Kredi konsumatore	8.89	9.91	9.60	Consumer credit
Kredi për qëllime të tjera	7.18	7.89	7.61	Credit for other purposes
<b>Normat e interesit të kredive per korporatat jofinanciare</b>				<b>Interest rates on nonfinancial corporations loans</b>
Kredi deri në 140 milion lekë	7.89	7.61	7.68	Loans up to to an amount of 140 millions of lek
Kredi mbi 140 milionë lekë	6.09	7.00	7.54	Loans over an amount of 140 millions of lek
<b>Norma e letrave me vlerë</b>				<b>Securities rates</b>
Bono thesari 1/				Treasury bills 1/
3-M	3.03	2.76	2.80	3-M
6-M	4.57	4.37	3.26	6-M
12-M	5.19	4.46	3.94	12-M

**Burimi :** Banka e Shqipërisë

**Source :** Bank of Albania

## TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2023

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2023

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M È R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	ITEMS
	<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>50,274</b>	<b>97,112</b>	<b>156,107</b>	<b>TOTAL REVENUE</b>
<b>I.</b>	<b>Të ardhura nga ndihmat</b>	<b>1,297</b>	<b>6,854</b>	<b>7,309</b>	<b>Grants</b>
<b>II.</b>	<b>Të ardhura tatimore</b>	<b>47,343</b>	<b>86,850</b>	<b>143,527</b>	<b>Tax Revenue</b>
<b>II.1</b>	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>33,341</b>	<b>60,922</b>	<b>104,674</b>	<b>From tax offices and customs</b>
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	16,977	30,519	45,902	V.A.T
2	Tatimi mbi Fitimin	2,397	4,875	21,608	Profit Tax
3	Akcizat	4,102	8,226	12,056	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	5,258	9,063	13,236	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	4,023	6,983	9,895	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	584	1,256	1,977	Customs Duties
<b>II.2</b>	<b>Të ardhura nga Pushteti Vendor</b>	<b>1,407</b>	<b>2,915</b>	<b>5,070</b>	<b>Revenues from Local Gov.</b>
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	284	533	1,029	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	0	5	12	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	1,123	2,377	4,030	Local Taxes
<b>II.3</b>	<b>Të ardh nga fondet speciale</b>	<b>12,596</b>	<b>23,013</b>	<b>33,783</b>	<b>Social Ins. contributions</b>
1	Sigurimi Shoqëror	10,820	19,834	29,176	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,712	3,046	4,402	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	64	133	205	Compensation income in the value of owners
<b>III.</b>	<b>Të ardhura Jotatimore</b>	<b>1,634</b>	<b>3,409</b>	<b>5,271</b>	<b>Nontax Revenue</b>
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	0	0	0	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	954	2,049	3,247	Income of budgetary institutions
3	Tarifat shërbimeve	214	404	642	Utility fees
4	Të tjera	465	955	1,364	Others
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>35,352</b>	<b>73,466</b>	<b>125,232</b>	<b>TOTAL EXPENDITURE</b>
<b>I.</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>34,324</b>	<b>71,699</b>	<b>112,498</b>	<b>Current Expenditures</b>
<b>I.1</b>	<b>Personell</b>	<b>7,247</b>	<b>14,580</b>	<b>21,963</b>	<b>Personnel expenditures</b>
1	Paga	6,218	12,504	18,832	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	1,020	2,053	3,087	Social insurance contributions
3	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	9	23	44	Higher education from its own income
<b>I.2</b>	<b>Interesat</b>	<b>5,426</b>	<b>7,657</b>	<b>12,051</b>	<b>Interest</b>
1	Të Brendshme	4,314	5,773	9,120	Domestic
2	Të Huaja	1,112	1,884	2,932	Foreign
<b>I.3</b>	<b>Shpenzime Operative Mirëmbajtje</b>	<b>1,635</b>	<b>5,742</b>	<b>10,294</b>	<b>Operational &amp; Maintenance</b>
<b>I.4</b>	<b>Subveconet</b>	<b>79</b>	<b>266</b>	<b>378</b>	<b>Subsidies</b>
<b>I.5</b>	<b>Shpenzime për fonde speciale</b>	<b>15,616</b>	<b>32,037</b>	<b>48,598</b>	<b>Social insurance outlays</b>
1	Sigurime Shoqërore	12,576	24,399	36,771	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	3,032	7,202	11,292	Health insurance
3	Fondi i kompensimit të pronarëve	8	436	535	Owners' Compensation Fund
<b>I.6</b>	<b>Shpenzime per Buxhetin Vendor</b>	<b>2,694</b>	<b>7,170</b>	<b>12,528</b>	<b>Local budget expenditure</b>
<b>I.7</b>	<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>1,627</b>	<b>4,248</b>	<b>6,685</b>	<b>Other expenditures</b>
1	Pagesa e Papunesisë	63	108	188	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	1,264	3,379	5,454	Economic Aid
3	Bonusi i lindjeve	300	500	700	Birth bonus
<b>I.8</b>	<b>Transferime Kapitale</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>Capital transfers</b>
<b>II</b>	<b>Fondi Rezerve, Kontigjenca</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>Reserve fund/contingency</b>
<b>III</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>1,028</b>	<b>1,767</b>	<b>12,734</b>	<b>Capital expenditures</b>
1	Financimi Brendshëm	0	286	9,564	Domestically financing
2	Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë	0	17	46	From higher education system's own revenues
3	Financimi Huaj	1,028	1,413	2,248	Foreign financed
<b>IV</b>	<b>Fondi i rindertimit</b>	<b>0</b>	<b>50</b>	<b>876</b>	<b>Reconstruction fund</b>
<b>V.</b>	<b>DEFICITI</b>	<b>-14,922</b>	<b>23,646</b>	<b>30,876</b>	<b>CASH BALANCE</b>
<b>V.1</b>	<b>FINANCIMI DEFICITIT</b>	<b>-14,922</b>	<b>-23,646</b>	<b>-30,876</b>	<b>CASH BALANCE FINANCING</b>
<b>V.2</b>	<b>Brendshëm</b>	<b>-14,096</b>	<b>-20,819</b>	<b>-24,359</b>	<b>Domestic</b>
1	Të ardhura nga privatizimi	5	9	17	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	10,909	5,506	12,662	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-25,010	-26,333	-37,038	Others
<b>V.3</b>	<b>I huaj</b>	<b>-826</b>	<b>-2,828</b>	<b>-6,517</b>	<b>Foreign</b>
1	Hua afatgjatë(e marrë)	962	1,961	2,097	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-189	-980	-709	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,599	-3,808	-7,905	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore	0	0	0	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source : Ministry of Finance and Economy

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2023**

Table of investments 2023

Të dhëna progresive (Progressive Data)

	Janar	Shkurt	Mars	
	January	February	March	
<b>Financim i brendshëm</b>	<b>-14,096</b>	<b>-20,819</b>	<b>-24,359</b>	<b>Domestic financing</b>
<i>Në %</i>	94.5	88.0	78.9	<i>In %</i>
<b>Financim i huaj</b>	<b>-826</b>	<b>-2,828</b>	<b>-6,517</b>	<b>Foreign financing</b>
<i>Në %</i>	5.5	12.0	21.1	<i>In %</i>
<b>Totali</b>	<b>-14,922</b>	<b>-23,646</b>	<b>-30,876</b>	<b>Total</b>
<i>Në %</i>	100	100	100	<i>In %</i>

**Burimi:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë

**Source:** Ministry of Finance and Economy

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE DHE TATIMORE 2023  
CUSTOMS AND TAX REVENUES 2023**

*Të dhëna progresive (Progressive Data)*

*në milionë Lekë ( in million ALL)*

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
Taksë doganore	584	1,256	1,977	Customs Duties
TVSH	9,878	20,632	32,958	V.A.T
Akcizë	4,102	8,226	12,056	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	235	455	827	Others (Mineral Rent)
<b>TOTALI</b>	<b>14,799</b>	<b>30,569</b>	<b>47,818</b>	<b>Total</b>
<b>TË ARDHURAT TATIMORE 2023 (TAX REVENUE)</b>				
TVSH	7,099	9,887	12,944	V.A.T
Tatim mbi fitimin	2,397	4,875	21,608	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	5,258	9,063	13,236	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	3,788	6,528	9,068	National taxes
<b>TOTALI</b>	<b>18,542</b>	<b>30,353</b>	<b>56,856</b>	<b>Total</b>
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM</b>	<b>33,341</b>	<b>60,922</b>	<b>104,674</b>	<b>OVERALL TOTAL</b>

**Burimi:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë

**Source:** Ministry of Finance and Economy

Tab - 7

**DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2023***The Deficit and Its Financing for 2023**Të dhëna progresive (Progressive Data)**Në milionë lekë (In million ALL)*

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
<b>TË ARDHURAT</b>	<b>50,274</b>	<b>97,112</b>	<b>156,107</b>	<b>REVENUE</b>
<b>SHPENZIMET</b>	<b>35,352</b>	<b>73,466</b>	<b>125,232</b>	<b>EXPENDITURES</b>
<b>BILANCI FISKAL</b>	<b>14,922</b>	<b>23,646</b>	<b>30,876</b>	<b>FISCAL BALANCE</b>
<b>FINANCIMI I BILANCIT FISKAL</b>	<b>-14,922</b>	<b>-23,646</b>	<b>-30,876</b>	<b>FINANCING</b>
<b>Financimi i brendshëm</b>	<b>-14,096</b>	<b>-20,819</b>	<b>-24,359</b>	<b>Domestic</b>
Të ardhura nga privatizimi	5	9	17	Privatization receipts
Hua-marrje e brendshme	10,909	5,506	12,662	Domestic borrowing
Të tjera	-25,010	-26,333	-37,038	Others
<b>Financimi i jashtëm</b>	<b>-826</b>	<b>-2,828</b>	<b>-6,517</b>	<b>Foreign</b>
a. Hua afatgjatë	962	1,961	2,097	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ripagesat	-1,599	-3,808	-709	Chang. of stat. Account
c. Ndryshimi i gjëndjes së arkës	-189	-980	-7,905	Repayments
d. Mbeshtetje Buxhetore	0	0	0	Budgetary Support

**Burimi:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë**Source:** Ministry of Finance and Economy

**BILANCI I PAGESAVE**

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	2019	2020	2021	3M_I_2022	3M_II_2022	3M_III_2022	3M_IV_2022	
<b>Llogaria korrente</b>	<b>-1,088.70</b>	<b>-1,152.73</b>	<b>-1,186.26</b>	<b>-260.80</b>	<b>-207.71</b>	<b>-166.05</b>	<b>-477.26</b>	<b>Current Account.</b>
<b>Bilanci tregtar</b>	<b>-3,143.80</b>	<b>-2,982.51</b>	<b>-3,829.34</b>	<b>-815.97</b>	<b>-986.43</b>	<b>-1,215.58</b>	<b>-1,239.59</b>	<b>Trade Balance.</b>
Eksporti I mallrave fob	906.50	793.63	1,264.79	482.59	520.78	476.93	463.72	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-4,050.30	-3,776.14	-5,094.13	1,298.56	1,507.21	1,692.51	1,703.31	Merchandise Imports. Fob
<b>Bilanci i shërbimeve</b>	<b>1,263.90</b>	<b>1,051.72</b>	<b>1,776.10</b>	<b>407.92</b>	<b>600.08</b>	<b>847.07</b>	<b>538.50</b>	<b>Services Balance.</b>
Shërbimet Kredi	3,404.60	2,226.22	3,466.03	865.20	1,212.22	1,586.69	1,125.81	Services Credit
Shërbimet Debi	2,140.70	1,174.50	1,689.93	457.27	612.14	739.63	587.31	Services Debt
<b>Bilanci i të ardhurave</b>	<b>-180.10</b>	<b>-219.34</b>	<b>-210.98</b>	<b>-96.09</b>	<b>-80.37</b>	<b>-80.74</b>	<b>-97.03</b>	<b>Balance of Incomes</b>
Të ardhurat Kredi	420.20	337.10	397.57	107.27	132.38	148.79	169.14	Income Credit
Të ardhurat Debi	-600.30	-556.44	-608.55	203.39	212.75	229.53	266.17	Income Debt
<b>Bilanci i transfertave</b>	<b>971.30</b>	<b>997.40</b>	<b>1,077.96</b>	<b>324.90</b>	<b>348.41</b>	<b>378.48</b>	<b>402.74</b>	<b>Balance of Transfers</b>
Transferta private	1,105.50	1,169.70	1,244.00	284.12	303.71	330.84	361.80	Private Unrequired Transfers
Transferrat shtetërore	-134.20	-172.30	-166.04	40.78	44.70	47.64	40.94	Official Unrequired Transfers
<b>Llogaria kapitale</b>	<b>76.10</b>	<b>143.60</b>	<b>358.46</b>	<b>9.54</b>	<b>-5.94</b>	<b>-6.61</b>	<b>23.13</b>	<b>Capital Account</b>
<b>Llogaria financiare</b>	<b>-827.00</b>	<b>-1,504.31</b>	<b>-1,554.51</b>	<b>-229.41</b>	<b>-206.19</b>	<b>-138.05</b>	<b>-299.34</b>	<b>Financial Account</b>
Investime direkte	-1,036.30	-893.56	-989.93	-277.44	-297.36	-300.27	-348.32	Direct Investment
Investime portofoli	140.60	-65.85	-83.95	136.68	77.36	84.64	278.94	Portfolio Investment
Investime të tjera	50.90	-403.80	-534.17	-108.30	2.77	56.93	-241.10	Other Capital
<b>Gabime dhe harresa neto</b>	<b>107.90</b>	<b>159.33</b>	<b>209.47</b>	<b>-67.10</b>	<b>-55.86</b>	<b>128.70</b>	<b>143.14</b>	<b>Net errors and omissions</b>
<b>Bilanci i përgjithshëm</b>	<b>-77.70</b>	<b>654.51</b>	<b>936.18</b>	<b>-88.95</b>	<b>-63.32</b>	<b>94.09</b>	<b>-11.65</b>	<b>Overall Balance</b>
Rezervat	-77.70	654.70	936.17	-88.94	-63.32	94.10	-11.64	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	-17.80	141.10	-53.54	-19.65	-11.04	-20.65	-11.14	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

## MJETET VALUTORE NETO

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhes					2023	2023	2023	2023	Millions of Lek End of Period
	2019	2020	2021	2022	Janar January	Shkurt February	Mars March		
<b>Mjete valutore neto</b>	733,114	803,487	937,814	920,586	923,043	909,583	896,913	<b>Net foreign assets</b>	
Pretendime ndaj jorezidentëve	794,006	860,750	1,027,069	1,014,295	1,013,021	993,155	983,219	Claims on nonresidents	
Minus Detyrime të jorezidentëve	60,892	57,263	89,255	93,709	89,978	83,572	86,306	Minus: Liabilities to nonresidents	
<b>Mjetet e brendshme</b>	950,426	1,047,835	1,084,106	1,142,948	1,227,452	1,215,126	1,211,224	<b>Domestic assets</b>	
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	378,524	435,613	412,253	436,931	509,869	499,139	494,123	Net claims on central government	
Pretendime ndaj sektoreve te tjere	571,902	612,221	671,852	612,512	717,583	715,987	717,101	Claims on other sectors	
<b>Detyrimet e parasë së gjerë</b>	1,318,662	1,456,993	1,582,310	1,618,704	1,682,906	1,665,290	1,651,678	<b>Broad Money liabilities</b>	
Paraja jashtë Korporatave Depozituese	291,409	344,560	366,251	372,377	387,505	385,104	382,754	Money outside depository corporations	
Depozita të transferueshme	408,780	490,394	584,631	614,325	660,677	649,048	642,476	Transferable deposits	
Depozita të tjera	618,473	622,039	631,428	632,002	634,724	631,138	626,448	Other deposits	
<b>Depozita të papërfshira në paranë e gjerë</b>	178,375	186,892	222,409	231,669	257,177	257,367	259,043	<b>Deposits excluded from Broad Money</b>	
Qeveria lokale dhe administrata publike								Local government and public administration	
Korporata të tjera financiare	3,879	4,666	5,877	6,918	7,376	7,100	7,402	Other financial corporations	
Korporata jofinanciare publike	336	252	392	386	383	384	384	Public nonfinancial corporations	
Korporata të tjera jofinanciare	8,238	6,925	16,599	10,539	10,411	9,775	10,892	Other nonfinancial corporations	
Sektorë të tjerë rezidentë	165,922	175,050	199,541	213,811	239,007	240,108	240,366	Other resident sectors	
<b>Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet</b>	6,656	5,926	7,288	7,523	8,020	7,942	8,834	<b>Securities other than shares</b>	
Korporata të tjera jofinanciare	101	57	67	204	292	288	311	Korporata të tjera jofinanciare	
Sektorë të tjerë rezidentë	6,555	5,869	7,221	7,319	7,728	7,654	8,522	Other resident sectors	
<b>Huatë</b>	2,527	3,757	3,507	4,692	8,793	9,787	6,141	<b>Loans</b>	
Qeveria lokale dhe administrata publike								Local government and public administration	
Korporata të tjera financiare	2,527	3,757	3,507	4,692	8,793	9,787	6,141	Other financial corporations	
Korporata jofinanciare publike								Public nonfinancial corporations	
Korporata të tjera jofinanciare								Other nonfinancial corporations	
Sektorë të tjerë rezidentë								other resident sectors	
<b>Llogari të pagueshme</b>	229	62	248	187	108	217	79	<b>Accounts payable</b>	
Korporata të tjera Financiare								Other financial corporations	
Korporata jofinanciare publike								Public nonfinancial corporations	
Korporata të tjera jofinanciare	1	5		44	1	7	0	Other nonfinancial corporations	
Sektorë të tjerë rezidentë	229	57	247	150	107	211	78	other resident sectors	
<b>Aksione dhe instrumenta të tjerë të kapitalit</b>	200,257	214,394	219,725	209,188	200,097	200,599	191,664	<b>Shares and other equity</b>	
Nga të cilat rezerva rivlerësimi	-2,652	-1,095	-5,442	-20,622	-34,632	-42,251	-46,571	Of which: Valuation adjustment	
<b>Të tjera neto</b>	-23,895	-17,621	-14,428	-11,273	-13,848	-18,044	-11,368	<b>Other items net</b>	
Detyrime të tjera	50,220	55,892	59,094	62,999	62,687	56,618	62,960	Other liabilities	
Minus: Mjete të tjera	74,115	73,514	73,521	74,262	76,535	74,662	74,327	Minus: Other assets	
<b>Axhustimi i konsolidimit</b>	729	919.0	862	2,332	1,173	1,551	2,066	<b>Consolidation adjustment</b>	

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

**Tab - 10** **KREDIA PËR EKONOMINË**  
*Credit to Economy*

Në milion Lekë Fundi i periudhës					2023	2023	2023	Million of Lek End of Period
	2019	2020	2021	2022	Janar January	Shkurt February	Mars March	
<b>Totali i kredisë</b>	570,792.2	608,779.8	666,178.4	700,096	711,525.5	709,935.9	711,060.8	<b>Total Credit</b>
<b>Kredia për qeverinë lokale dhe administratën publike</b> □	560.6	429.1	313.2	214	197.2	191.6	178.2	<b>Credits to local Government</b>
Në lekë	560.6	429.1	313.2	214	197.2	191.6	178.2	in Lek
Në valutë	-	-	-	-	-	-	-	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat jofinanciare publike</b>	24,182.4	15,150.8	22,521.8	23,720	22,639.4	22,620.2	20,752.9	<b>Credits to Public Non-financial Corporations</b>
Në lekë	18,489.7	11,819.6	9,210.6	10,145	9,148.8	9,443.1	7,938.8	in Lek
Në valutë	5,692.7	3,331.2	13,311.3	13,575	13,490.6	13,177.1	12,814.1	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat e tjera jofinanciare</b>	335,884.5	370,356.3	395,162.7	410,799	407,332.3	405,116.4	405,170.1	<b>Credits to other Non-financial Corporations</b>
Në lekë	141,240.5	161,975.3	172,000.2	175,069	169,606.3	169,711.7	171,992.7	in Lek
Në valutë	194,644.1	208,381.0	223,162.5	235,685	237,726.0	235,404.7	233,177.4	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat e tjera financiare</b>	13,555.1	13,169.1	13,815.7	14,621	15,839.8	15,875.2	16,403.0	<b>Credits to Other Financial Corporations</b>
Në lekë	8,023.8	7,489.2	7,772.8	7,895	8,709.3	8,910.3	9,061.1	in Lek
Në valutë	5,531.3	5,679.9	6,043.0	6,726	7,130.5	6,964.9	7,341.9	in Foreign Currency
<b>Kredia për sektorë të tjerë rezidentë</b>	196,609.5	209,674.5	234,365.0	250,768	265,516.8	266,132.5	268,556.8	<b>Credits to other resident sectors</b>
Në lekë	130,409.2	138,986.4	158,093.0	168,560	175,884.0	176,033.4	177,500.4	in Lek
Në valutë	66,200.3	70,688.1	76,272.0	82,207	89,632.8	90,099.1	91,056.4	in Foreign Currency

*Burimi* : Banka e Shqipërisë

*Source* : Bank of Albania

Tab - 11

**OFERTA E PARASË**

Money Supply

**Mujor-Monthly**

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2019	2020	2021	2022	2023	2023	2023	Millions of LEK End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
Baza monetare	433,951	534,347	565,163	563,466	547,780	544,288	543,057	Monetary base
Paraja jashtë korporatave deponituese	291,409	344,560	366,251	372,093	387,505	385,104	382,754	Currency outside depository corporations
Agregati M1	523,968	637,317	701,404	706,376	740,218	732,161	728,380	M1 Aggregate
Agregati M2	758,022	862,338	918,474	915,608	943,595	935,575	932,028	M2 Aggregate

**Burimi** : Banka e Shqipërisë**Source** : Bank of Albania

## DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2019	2020	2021	2022	2023 Janar January	2023 Shkurt February	2023 Mars March	Millions of Leks End of Period
<b>Totali i depozitave</b>	<b>1,027,253</b>	<b>1,112,433</b>	<b>1,216,059</b>	<b>1,251,512</b>	<b>1,295,401</b>	<b>1,280,186</b>	<b>1,268,925</b>	<b>Total of deposits</b>
<b>Në lekë</b>	<b>466,613</b>	<b>517,778</b>	<b>552,223</b>	<b>544,487</b>	<b>556,090</b>	<b>550,471</b>	<b>549,275</b>	
<b>Depozitat e transferueshme</b>	<b>190,538</b>	<b>241,316</b>	<b>276,074</b>	<b>276,198</b>	<b>296,645</b>	<b>291,018</b>	<b>289,398</b>	<b>Transferable deposits</b>
Qeveria lokale dhe administrata publike	1,624	1,644	1,302	138,831	1,664	1,738	1,663	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	10,667	13,747	17,118	8,144	17,539	17,319	16,808	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	3,694	3,666	4,744	9,975	6,277	5,769	6,639	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	49,099	66,074	77,758	39,408	83,716	77,057	74,770	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	125,454	156,185	175,154	127,392	187,449	189,135	189,518	Other resident sectors
<b>Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)</b>	<b>42,021</b>	<b>51,442</b>	<b>59,079</b>	<b>120,298</b>	<b>56,068</b>	<b>56,039</b>	<b>56,228</b>	<b>Liquid deposits (Sight deposits)</b>
Qeveria lokale dhe administrata publike				59,503				Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	120	166	1,762	2,750	1,534	1,534	1,566	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	87	131	78	1,406	2	20	15	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	2,873	3,970	3,554	1,409	2,917	2,941	3,060	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	38,942	47,175	53,686	28,345	51,615	51,544	51,587	Other resident sectors
<b>Depozita të tjera</b>	<b>234,053</b>	<b>225,021</b>	<b>217,070</b>	<b>131,361</b>	<b>203,377</b>	<b>203,415</b>	<b>203,648</b>	<b>Other deposits</b>
Qeveria lokale dhe administrata publike	10	10		208,787				Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	709	1,465	757	594	598	598	599	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	4,147	4,868	5,136	2,525	4,930	4,609	4,747	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	7,978	6,836	7,598	5,483	6,488	6,653	7,080	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	221,210	211,841	203,579	101,868	191,361	191,555	191,223	Other resident sectors
<b>Në valutë</b>	<b>560,640</b>	<b>594,655</b>	<b>663,836</b>	<b>707,025</b>	<b>739,311</b>	<b>729,715</b>	<b>719,650</b>	<b>In foreign currency</b>
<b>Depozitat e transferueshme</b>	<b>218,241</b>	<b>249,078</b>	<b>308,556</b>	<b>342,743</b>	<b>364,032</b>	<b>358,030</b>	<b>353,079</b>	<b>Transferable deposits</b>
Qeveria lokale dhe administrata publike	158	82	39	171,395	69	170	89	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	2,688	2,246	2,465	1,917	4,640	4,308	4,561	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	5,360	6,742	6,143	5,193	8,342	7,323	7,773	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	79,001	90,281	116,544	69,247	139,934	136,952	134,617	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	131,036	149,726	183,366	166,155	211,045	209,277	206,038	Other resident sectors
<b>Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)</b>	<b>106,417</b>	<b>120,699</b>	<b>136,407</b>	<b>170,579</b>	<b>143,118</b>	<b>138,463</b>	<b>135,413</b>	<b>Liquid deposits (Sight deposits)</b>
Qeveria lokale dhe administrata publike				140,743				Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	136	97	94	110	106	102	96	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	1	1	10	57	0	10	9	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	2,786	5,845	3,739	2,036	6,872	5,158	5,482	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	103,495	114,755	132,565	70,314	136,139	133,193	129,827	Other resident sectors
<b>Depozita të tjera</b>	<b>235,982</b>	<b>224,878</b>	<b>218,873</b>	<b>180,050</b>	<b>232,162</b>	<b>233,222</b>	<b>231,158</b>	<b>Other deposits</b>
Qeveria lokale dhe administrata publike			24	111,825	234.5	231.7	204.4	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,522	1,732	1,519	990	3,520	3,203	3,139	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	7,058	6,939	8,936	4,482	6,050	6,973	7,181	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	11,662	10,854	12,622	12,590	23,904	24,679	24,746	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	215,741	205,353	195,771	107,232	198,454	198,135	195,887	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

**Tregues të shëndetit financiar (FSI)**  
 (në përqindje)

**Financial Soundness Indicators (FSI)**  
 (in percentage)

Përshkrimi i treguesit	Janar 23	Shkurt 23	Mars 23	Index description
<b>Tregues me bazë kapitalin</b>				<b>Capital-based</b>
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %)			19	Regulatory capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali rregullator (mln lekë)			179,418	Regulatory capital (million lek)
Aktive të ponderuara me rrezik (mln lekë)			949,150	Risk-weighted assets
Kapitali rregullator i nivelit I ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %)			17.45	Regulatory Tier 1 capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali ndaj totalit të aktiveve				Capital as a percent of total assets
Kapitali rregullator i nivelit I ndaj totalit të aktiveve	8.64	8.63	8.85	Regulatory Tier 1 capital as a percent of total assets
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve (në %)	9.30	9.31	9.58	Regulatory capital as a percent of total assets (in %)
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve (në %)	9.86	10.07	9.75	Shareholders' equity as a percent of total assets (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit (në %)				Nonperforming loans net of provisions as a percent of capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %)	7.85	8.24	7.90	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory Tier1 capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit rregullator (në %)	7.29	7.64	7.29	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit aksioner (në %)	6.88	7.06	7.17	Nonperforming loans net of provisions as a percent of shareholders' equity (in %)
Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore) (në %)	14.52	17.01	14.58	Return on equity (ROE) (annual basis) (in%)
Pozicioni i hapur neto ne valutë ndaj kapitalit (në %)				Net open position in foreign exchange as a percent of capital (in %)
Pozicioni i hapur neto ne valutë ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %)	5.54	7.87	7.15	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory Tier 1 capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator (në %)	5.15	7.30	6.60	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit aksioner (në %)	4.86	6.75	6.48	Net open position in foreign exchange as a percent of shareholders' capital (in %)
<b>Tregues me bazë aktivet</b>				<b>Asset-based indicators</b>
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda e gjerë)	30.98	30.20	30.04	Liquid assets as a percent of total assets (broad measure)
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda bazë)	11.65	11.35	29.32	Liquid assets as a percent of total assets (core measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda e gjerë)	42.89	42.22	41.66	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (broad measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda bazë)	16.12	15.86	40.67	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (core measure)
Kthimi nga aktivet (ROA) (bazë vjetore) (fitimi neto para taksave)	1.74	2.01	1.70	Return on assets (ROA) (annual basis) (net profit before taxes)
Huatë me probleme (bruto) ndaj totalit të huave (në %)	5.10	5.16	5.15	Nonperforming loans (gross) as a percent of total loans (in %)
<b>Tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve</b>				<b>Income and expense-based</b>
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	87.44	77.05	82.66	Interest margin to gross income
Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto	53.32	49.45	53.09	Noninterest expenses to gross income
<b>Të tjera</b>				<b>Other</b>
Numri i bankave	11.00	11.00	11.00	Number of banks

**Burimi** : Banka e Shqipërisë

**Source** : Bank of Albania